

Drejtoria Rajonale Tirane

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __ / __ / 2023

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Drejtoria Rajonale e OSSH Tirane

Adresa Rr. Reshit Petrela, Perballe Dispanserise, Tiranë

Tel/Faks 0694140752

E-mail zhuljeta.bektashi@ossh.al

Ueb-faqe www.ossh.al

Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, me objekt: Blerje 3 (tre) bileta avioni me destinacion Tiranë – Athinë - Tiranë.

Data e zhvillimit do të jetë **05.06.2023, ora 10:00** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Blerje bileta avioni me destinacion Tiranë – Athinë – Tiranë në datat 06.06.2023 – 08.06.2023	3

Autoriteti kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt “Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi me itinerar Tiranë– Athinë-Tiranë”.

Përshkrimi, kërkesat dhe mënyra e furnizimit:

Drejtoria Rajonale Tirane

- Blerje bileta udhëtimi me avion (klasi ekonomik) vajtje-ardhje me itinerar Tiranë – Athinë- Tiranë - copë 3(tre) persona adult.

Të dhëna për biletat e datës 06.06.2023-08.05.2023;

- Data e nisjes nga Tirana për në Athinë datë 06.06.2023, me orar nisje nga Tirana pas ores 12:00, dhe datë kthimi pas ores 18.00 date 08.06.2023;
- Fluturimi ne vajtje të jetë direkt (pa tranzit);
- Klasi ekonomik;
- Me bagazhe (20 kg);

Operatori Ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a dokumentacionin si më poshtë:

- a- Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar me lart duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit, si dhe kodin e llogarisë së klientit .
- b- Operatori ekonomik të paraqese Ekstraktin e QKB-së, ku aktiviteti tregtar të jetë objekt i kësaj procedure si dhe statusi të jetë aktiv,nuk duhet te jete denuar me vendim te gjykates se formes se prere per vepra qe lidhen me veprimtarine profesionale.
Kjo pike te plotesohet nga operatori me nje Vete- deklarate.
- c- Formulari i Ofertës, i firmosur dhe vulosur nga operatori ekonomik dhe IBAN.
- d- Operatori ekonomik me anë të një vetë deklarami, duhet të marrë përsipër se:
Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.
- i- Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër për gjatë 24 orëve si dhe çdo ditë të javës (24x7) përfshirë këtu dhe ditët e festave zyrtare.

Shenim: *Operatori Ekonomik ofertues qe do te kryeje sherbimin, do te mbaje pergjegjesi te plote ne rastet kur udhetaret do te humbasin udhetimin per faj te kompanise , si dhe do te rimbursojne pjese e humbur te udhetimit.*

Drejtoria Rajonale Tirane

Ne kete rast operatori ekonomik fitues do te plotesoje nje vete deklarate ku merr persiper pergjegjesine e lartpermendur.

Afati i dorëzimit të dokumenteve është brenda 2 (dy) orëve nga shpallja e njoftimit fituesit. Dokumentacioni i kerkuar nga Autoriteti Kontraktor ne permbushje te kerkesave te percaktuara ne Ftesen per Oferte duhet te dorezohet nga Operatori Ekonomik fitues ne Zyren e Protokollit te Autoritetit Kontraktor referuar udhezimit nr.4 date 20.05.2022 per disa shtesa ne udhezimin nr. 3 date 18.06.2021.

Në të kundërt, do të bëhet kalimi te ofertuesi i radhës i kualifikuar në SPE, e kështu me radhë, deri në ofertuesin e fundit e mbetur në klasifikim.

Autoriteti Kontraktor, nuk do të pranojë shërbim nga operatorët ekonomikë që nuk mundësojnë lëshimin e faturës elektronike sipas ligjit të ri të fiskalizimit, si dhe detajimin e çmimeve për çdo biletë.

Operatori Ekonomik fitues per nenshkrimin e nje kontrate / dorezimin e fatures tatimore duhet te kete:

- ✓ Kopje te Certifikates Elektronike per Fiskalizimin, per tatimpaguesit qe perdorin Platformen Qendrore te Faturave.
- ✓ Kopje te Certifikates elektronike per Fiskalizim dhe Kopje te vlefshme te Kontrates se lidhur me Shoqerine e Certifikuar per zgjidhjen e software-ike ne perdorim, per tatimpaguesit qe leshojne faturat nepermjet zgjidhjes software-ike.

Ne ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhëna të plota të personit të kontaktit.

Drejtoria Rajonale Tirane